



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhësi Teksti

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione / 20 seminare
Viti / Semestri : Viti III, semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – *Gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian*
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë të njohë konceptet që lidhen me tekstin dhe elementët përbërës të tij; analizojë tipologji tekstore të ndryshme, duke u përqëndruar në elementët që realizojnë Kohezionin dhe Koherencën e tekstit; përzgjedhë dhe krijojë tekste në mënyrë të pavarur.

Objektivat specifike lëndore:

Studenti duhet të jetë i aftë të:

1. Të asimilojë konceptet kryesore të shkollave të ndryshme gjuhësore mbi Tekstin dhe evolucionin e Gjuhësisë së tekstit.
2. Të punojë mbi tekste të ndryshme, duke analizuar gjithë elementët gjuhësorë dhe jashtëgjuhësorë të tij.
3. Të dallojë tipologjitë e ndryshme tekstuale, si teksti rrëfyes, ai përshkrues, teksti argumentues e informative, teksti teatral dhe poetik etj.
4. Të përftojë njohuri të përgjithshme gjuhësore mbi koncepte si Kohezioni, Koherenca, Koteksti dhe Konteksti gjuhësor e jashtëgjuhësor, Progresioni tematik, Anafora, Deiksisi etj.